



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN
E TË DHËNAVE PERSONALE

Nr. 136/4 Prot

Tiranë, më 27.2.2017

VENDIM

Nr. 41, datë 27.2.2017

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar, Ligjit Nr.44/2015 datë 30.04.2015 "*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*", si dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit "*Fiber Group*" sh.p.k. Tiranë, me aktivitetin e tij në formën ligjore person juridik,

VËREJ SE:

Në zbatim të Urdhrit Nr.25 datë 23.01.2017 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, për kryerjen e hetimit administrativ, më datë 26.01.2017 e në vazhdim, grupi i inspektimit filloi procesin e hetimit administrativ pranë kontrolluesit, "*Fiber Group*" sh.p.k. Tiranë, me objekt:

- Zbatimi i Ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*" i ndryshuar dhe akteve të miratuara nga Komisioneri, në lidhje me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, gjatë kryerjes së aktivitetit të kontrolluesit "*Fiber Group*" sh.p.k. Tiranë.

Në datë 26.01.2017, grupi i kontrollit komunikoi me përfaqësuesit e kontrolluesit, mbi detyrimin për zbatim të Urdhrit Nr.25 datë 23.01.2017 të Komisionerit.

"*Fiber Group*" sh.p.k. Tiranë, sipas ekstraktit nga regjistri tregtar për të dhënat e subjektit, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me objekt të aktivitetit: Operimi në sektorin e telekomunikacionit duke kryer çdo lloj veprimtarie nëpërmjet telefonit për llogari të vet, apo të tretëve me seli në Shqipëri apo dhe në çdo vend tjetër që ka lidhje me Republikën e Shqipërisë. Data e themelimit është 16.05.2015, me NIPT L52519403R.

Nga hetimi administrativ i kryer pranë këtij kontrolluesi u konstatua:

1. Kontrolluesi nuk disponon rregullore për mbrojtjen e të dhënave personale.

2. Kontrolluesi ka në proces instalimin e sistemit (CCTV) të video-vëzhgimit. Në degën e Rrugës së Barrikadave ku ka përfunduar procesi i instalimit, janë vendosur tabela informuese mbi prezencën dhe monitorimin e ambienteve nëpërmjet sistemit, por jo sipas formatit standard të miratuar nga K.D.I.M.D.P.
3. Nga verifikimi paraprak në Regjistrin Elektronik të K.D.I.M.D.P.-së, kontrolluesi ka kryer veprime në sistem, por nuk e ka finalizuar "Njoftimin" në këtë sistem. Kontrolluesi e realizoi detyrimin pranë Zyrës së Komisionerit, në 30.01.2017.
4. Kontrolluesi nuk ka marrë pëlqimin e punonjësve për monitorimin e tyre gjatë orarit të punës, nëpërmjet sistemit të kamerave vëzhguese (CCTV).

Konstatimi i pikës 1 të këtij proces verbali, përbën shkelje administrative të nenit 27 të Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar.

Konstatimi i pikës 3 të këtij proces verbali, përbën shkelje administrative të nenit 21 të Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar.

Konstatimi i pikës 4 të këtij proces verbali, përbën shkelje administrative të nenit 5 dhe 6 të Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar.

Në cilësinë provës materiale, këtij procesverbali i bashkëngjiten këto dokumente:

1. Rregullore e brendshme për sigurinë e ruajtjen ambienteve, të sigurisë fizike të kompanisë "Fibër Group" sh.p.k. Tiranë.
2. Kontratë individuale pune me punëmarrësin.
3. Kontratë me klientin italian.
4. Kontratë me instaluesit e sistemit të video-vëzhgimit (CCTV).
5. Deklaratë konfidencialiteti e punëmarrësve.
6. Fotografji nga ambientet e kontrolluesit, të cilat janë nën mbikëqyrjen e sistemit të video-vëzhgimit (CCTV).
7. Printime dhe fotografji nga sistemi i video-vëzhgimit (CCTV), dhe ambientet e mbikëqyrura.
8. Ekstrakti Q.K.B.-së.

Pas procesit administrativ të kontrollit dhe identifikimit të gjetjeve, në prani të përfaqësuesve të kontrolluesit u hartua dhe lexua proces verbali përkatës. Përfaqësuesit e kontrolluesit u shprehën:

"1-Neve na rezultonte i përfunduar vetdeklarimi online, por sot na u informua se procesi online është në statusin pezull. Brenda 24 orësh do të përfundojmë vetdeklarimin.

2-Kompania ka bërë rregullore të brendshme dhe marrëveshje konfidencialiteti, e cila është firmosur nga punonjësit.

3-Procesi i instalimit të kamerave nuk ka përfunduar dhe për këtë kërkojmë bashkëpunimin tuaj deri në konkludim".

Në zbatim të neneve 87-89 të Ligjit Nr. 44/2015 datë 30.04.2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", përpara marrjes së aktit final, kontrolluesi "Fiber Group" sh.p.k. Tiranë, është njoftuar zyrtarisht për pjesëmarrje në seancë dëgjimore që do zhvillohej në datë 08.02.2017, për të ushtruar të drejtën e tij për tu dëgjuar. Përfaqësuesit e kontrolluesit paraqitën pretendimet si më poshtë:

"Në lidhje me shkkeljen e parë administrative sqarojmë se, shoqëria "Fiber Group" sh.p.k., ju bën me dije se ajo nuk realizon përpunim të të dhënave të shtetasve shqiptarë, në kuptim të nenit 21-22 të Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, përveç atyre me të cilët ka një marrëdhënie punësimi.

Nisur nga ky fakt, sipas Vendimit Nr.4 të Komisionerit për "Përcaktimin e Rasteve për Përfashimet nga Detyrimi për Njoftimin e të Dhënave Personale, që Përpunohen, pika b, parashikohet se:

b) Kur përpunimi i këtyre të dhënave lidhet me menaxhimin e burimeve njerëzore në sektorin publik dhe privat, në ushtrimin e të drejtave e të detyrimeve, të parashikuara në aktet ligjore dhe nënligjore, dalë në zbatim të tyre, nëse përpunimi kufizohet në:

- i) qëllimin e pranimit në punë;*
- ii) aplikimet;*
- iii) konkurrimet;*
- iv) emërimet;*
- v) largimet nga detyra;*
- vi) ngritjet në detyrë;*
- vii) vlerësimet e rezultateve të punës;*
- viii) masat disiplinore;*
- ix) regjistrin e personelit;*
- x) kualifikimet;*
- xi) të dhënat në kontratën e punës;*
- xii) përllogaritjet e pagave.*

Njoftimi për përpunimin e të dhënave personale, pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, nuk është i nevojshëm.

Gjithsesi, pavarësisht mungesës së detyrimit ligjor "Fiber Group" sh.p.k. ka realizuar njoftimin.

Në lidhje me shkkeljen e dytë administrative, mbi Rregulloren për Mbrojtjen e të Dhënave Personale shoqëria "Fiber Group" sh.p.k., është bazuar në bazën e të dhënave dhe software-n lidhur me të dhënat personale të klientëve, duke mos paraqitur rregulloren e kërkuar, e cila ishte ekzistuese, por mungonte në formën hard copy. Shoqëria paraqet Rregulloren e plotësuar për K.D.I.M.D.P.

Në lidhje me **shkeljen e tretë administrative**, për sa i përket sistemit të video vëzhgimit, "Fiber Group" sh.p.k. është në proces të papërfunduar të instalimit të kamerave të sigurisë. Sistemi CCTV nuk është ende plotësisht operativ.

Fakti që "Fiber Group" sh.p.k. në arredimin e saj të brendshëm, ndarjen midis sallave dhe zyrave të ndryshme e ka të realizuar me parete xhami dhe jo prej muri, nuk mund të konsiderohet shkelje, se sallat e operatorëve janë ambiente të survejuara dhe nuk passjell shkelje të dispozitave të ligjit.

Si konkluzion, kundërshtojmë shkeljet e pretenduara sipas Proces-Verbalit datë 27.01.2017".

Zyra e Komisionerit, pasi shqyrtoi pretendimet e mësipërme shprehet:

Në lidhje me pikën 1 të pretendimeve:

- Detyrimi për njoftim, në Regjistrin e kontrolluesve pranë Zyrës së Komisionerit, fillon që në fillimet e aktivitetit të një kompanie, e cila në këndvështrim të ligjit është kontrollues. Zyra e Komisionerit, për dy vjet nuk ka pasur informacion mbi: ekzistencën e këtij kontrolluesi, gamën e të dhënave që ai përpunon, mënyrën se si i përpunon dhe mbron ato, qëllimin, kategoritë, aktet në funksion të mbrojtjes së të dhënave etj. Kjo përbën shkelje, pasi për këtë periudhë dy vjeçare, është shmangur monitorimi i Zyrës së Komisionerit, si një tagër i tij parashikuar në nenin 31, pika 2 e Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, dhe duke rënë ndesh gjithashtu me nenin 21, pika 1 e këtij ligji.
- Pretendimi si më sipër, i bazuar në Vendimin Nr.4, datë 27.12.2012, nuk është i duhuri, pasi grupi i kontrollit nuk ka konstatuar shkelje, të cilat mund përfshihen tek rastet përjashtimore sipas këtij vendimi. Gjithashtu, duke ju referuar listës së dokumentacionit të nevojshëm për personelin, (pika 2.1. e Regullores së Brendshme e "Fiber Group" sh.p.k.) grumbullohen dhe përpunohen të dhëna të tjera që e tejkalojnë listën e këtij vendimi, duke përfshirë edhe mos deklarimin e përpunimit e të dhënave nëpërmjet sistemit të video-vëzhgimit (CCTV).
- Në objektin e aktivitetit të kontrolluesit, në asnjë rast nuk shprehet se klientët janë italianë, por citohet si vijon:
"Operon në sektorin e telekomunikacionit duke kryer çdo veprimtari nëpërmjet telefonit për llogari të vet apo të të tretëve me seli në Shqipëri apo në çdo vend tjetër që ka lidhje me Republikën e Shqipërisë etj."

Në lidhje me pikën 2 të pretendimeve:

Në cilësinë e provës materiale, grupi i kontrollit ka disponuar pamje nga 13 kamerat vëzhguese aktive të një prej filialeve të "Fiber Group" sh.p.k., të cilat tregojnë fare qartë pamjen e vendeve të punës të punëmarrësve.

Zyra e Komisionerit, ju bën me dije se, Ligji Nr.9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, nuk ndalon masat e sigurisë së kontrolluesit në interes të aktivitetit të tij tregtar, por ky ligj njëkohësisht detyron kontrolluesit të marrin masat e sigurisë për të dhënat e personale të subjekteve të të dhënave, dhe pëlqimin e tyre (në këtë rast të punëmarrësve), kur ata vëzhgohen nga kamerat në mënyrë direkt apo indirekte.

Theksoj se, kontrolluesi gjendet në kushtet e pikës 3, gërma “b”, sipas së cilës citohet:

“3. Përpunimi i të dhënave personale me anë të një sistemi video survejimit është i ligjshëm:

b) me pëlqimin e subjektit të të dhënave, por praktikisht kjo është e mundshme vetëm në raste shumë të kufizuara, atëherë kur identifikimi i një grupi personash që janë brenda zonës së kamerës bëhet në mënyrë të qartë”.

Në lidhje me pikën 3 të pretendimeve:

Në lidhje me pretendimin se rregulloren nuk e kishit në *hard copy*, grupit të kontrollit nuk ju vu në dispozicion një rregullore në ndonjë formë tjetër elektronike.

Zyra e Komisionerit, vlerëson faktin që, kontrolluesi “Fiber Group” sh.p.k. Tiranë, ka siguruar pëlqimin e punëmarrësve mbi vëzhgimin e tyre me kamera survejuese, gjatë kohës së punës, ka kryer detyrimin për njoftim, pikërisht në datën kur ka filluar inspektimi administrativ, si dhe ka hartuar rregulloren për mbrojtjen e të dhënave personale.

Sa më sipër, Zyra e Komisionerit konkludon se, shkeljet e konstatuara gjatë ushtrimit të hetimit administrativ në kuptim të nenit 39 pika 1, gërma “a” dhe “d” të Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, përbëjnë “kundërvajtje administrative”. e cila sanksionohet me gjobë si më poshtë:

“1.Rastet e përpunimit të të dhënave në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji kur nuk përbëjnë kundërvajtje penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen më gjobë, si më poshtë:

a) Kontrolluesit që përdorin të dhëna personale në kundërshtim me kreun II “Përpunimi i të dhënave personale, dënohen me 10 000 deri në 500 000 lekë;”.

dh) kontrolluesit ose përpunuesit, që nuk marrin masat e sigurisë së të dhënave të përcaktuar përkatësisht në nenin 27 të këtij ligji etj., dënohen me 10 000 deri në 150 000 lekë;”.

Kontrolluesi “Fiber Group” sh.p.k. Tiranë, në formën ligjore të aktivitetit të tij është person juridik dhe sipas nenit 39/2 për kundërvajtjet e mësipërme, dënohet me dyfishin e gjobës së përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.

Për zgjedhjen e masës së gjobës, Komisioneri ka parasysh faktin se, shkeljet e konstatuara konsistojnë në moszbatim të ligjit, akteve nënligjore dhe parimeve bazë të mbrojtjes së të

dhënave personale. Ato lidhen me cënimin e sigurisë së të dhënave personale të subjekteve të të dhënave, kryesisht për kategorinë "punëmarrës".

Gjithashtu, në zgjedhjen e masës së gjobës, Komisioneri ka parasysh bashkëpunimin e kontrolluesit me grupin e hetimit administrativ.

PËR KËTO ARSYE:

Në zbatim të neneve 5 dhe 6, Kreu II, neni 39 pika 1, gërmat "a" dhe "dh", nenit 39, pika 2 e Ligjit Nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, si dhe akteve të Komisionerit,

V E N D O S A:

1. Dënimin e kontrolluesit "Fiber Group" sh.p.k. Tiranë, me gjobë në vlerën **30.000 (tridhjetë mijë) lekë** për shkelje të detyrimeve të përcaktuar në nenin 5 dhe 6, kreu II të Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar.
2. Dënimin e kontrolluesit "Fiber Group" sh.p.k. Tiranë, me gjobë në vlerën **20.000 (njëzet mijë) lekë** për shkelje të detyrimeve të përcaktuar në nenin 27 të Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar.
3. Gjoha arkëtohet nga kundërvajtësi në Buxhetin e Shtetit, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga komunikimi i këtij vendimi. Me kalimin e afatit të ankimit, ky vendim kthehet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga zyra e përmbarimit.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga komunikimi i këtij vendimi.

Ky vendim u shpall sot, më 27. 22017.

